Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0019
Data e Vendimit: 16.01.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, , si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2020pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "D & T Group" SH.P.K. kundër vendimit të AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Auto bartëse (marimangë) për PK-në" me numër prokurimi 214-24-10564-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, U.D Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 16.01.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si jashteafatshme, ankesa e OE "D & T Group" SH.P.K me nr. të protokollit 2025/0019, e datës 06.01.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Auto bartëse (marimangë) për PK-në" me numër prokurimi 214-24-10564-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Policia e Kosovës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 06.01.2025, ka pranuar ankesën e OE "D & T Group" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me Auto bartëse (marimangë) për PK-në" me numër prokurimi 214-24-10564-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Policia e Kosovës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 08.11.2024, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërkaq me datën 17.12.2024 është publikuar formulari për korrigjimin e gabimeve. Hapja e ofertave është paraparë të bëhet me datën 30.12.2024.

Operatori Ekonomik "D & T Group" SH.P.K me datën 25.12.2024, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me datën 06.01.2025.

- *Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se OE kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse me datën 30.12.2024 kur është planifikuare hapja e ofertave ndërsa kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 25.12.2024, më pak se pesë (5) ditë kalendarike.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni "kërkesat për rishqyrtim" brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar në Autoritetin Kontraktues me datën 25.112.2024 është parashtruar jashtë afatit ligjor, dhe jo ashtu siç është paraparë në nenin 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik.

-Përfundim-

Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: "..në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave".

Autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Auto bartëse (marimangë) për PK-në" me numër prokurimi 214-24-10564-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Agim Sheqiri
U.D Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **"D & T Group" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: